



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Hartimi i tezës së diplomës

Ngarkesa: 6 ECTS, 60 orë në klasë: 30 orë leksione, 30 orë seminare
Viti / Semestri : Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i Shkencave, ‘‘Mësuesi në Gjuhë Angleze ‘‘
Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 5, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike për procesin e shkrimit akademik në funksion të përgatitjes së temës së masterit. Të zhvillojë aftësitë e kërkimit dhe të analizës së të dhënave në mënyrë të strukturuar dhe të argumentuar. Të nxisë përdorimin e stilit akademik dhe formal në të gjitha fazat e punës kërkimore shkencore.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohë studentët me hapat konkretë në ndërtimin e temës së masterit dhe organizimin e kapitujve.
2. Të aftësojë studentët të përdorin burime të ndryshme shkencore për përmblidhje, perifrashim, citim korrekt dhe ndërtimin e përfundimeve.
3. Të mësojë studentët të analizojnë të dhëna sasiore dhe cilësore dhe t’i paraqesin ato nëpërmjet mjeteve vizuale (tabela, grafikë, figura).

Rezultatet pritshme:

Në përfundim të kësaj lënde, studenti duhet të jetë në gjendje të:

1. Konceptojë dhe strukturojë temën e tij/saj të masterit sipas standardeve akademike.
2. Organizojë me qartësi kapitujt dhe elementët përbërës të një punimi kërkimor.
3. Përmblidhë dhe perifrashojë burime akademike duke respektuar normat e citimit dhe të referencimit.
4. Analizojë dhe interpretojë të dhëna sasiore dhe cilësore me mjete të përshtatshme.
5. Hartojë përfundime të qarta dhe të argumentuara dhe të përdorë stilin formal akademik në gjithë punën shkencore.